

Për udhëheqësit turq kjo kohë është përmbyllur. Ata po i shumëzojnë marrëveshjet dhe vizitat me Sirinë, me Iranin, me Sudanin dhe po pleksen me organizatat islamiste ekstremiste. Tashmë vlen më shumë të jenë kreu i krenarisë muslimane sesa shembulli i islamit laik.

Kthesa e Turqisë, gabim strategjik

Njëmbëdhjetë shtatori i sivjetshëm shënoi një kthesë madhore në marrëdhëniet midis Turqisë dhe Bashkimit Europian. Nëpërmjet ministrit të vet të Punëve të Jashtme, Turqia ltheu mbrapsht ofertën europiane për të shqyrtuar së bashku çështjet e mëdha strategjike për botën, me ngulminin paraprakisht për të shpejtuar anëtarësimin e vet, duke "lënë mënjanë" aspektet e politikës së saj që përbëjnë pengesë, ndër të cilat edhe pushtimin ushtarak të një pjese të Qipros. Prej kohësh parandihet që midis të 27-ëve dhe fqinjëve të tyre aziatik do të ketë krizë. Vetë ideja e anëtarësimit të Turqisë është aq e habitshme, sa nuk mund të ndodhte ndryshe. Edhe me vetë referendumin kushtetues, që u mbajt më 12 shtator, anëtarësimi u përdor përsëri në shërbim të politikës së brendshme turke, për të përshpejtuar modernizimin e vështirë të një vendi i cili ka përfutur tashmë shumë nën këtë emër. Kjo do të thotë se Bashkimi Europian ka ndikim më shumë nga ç'e merr atë vetë me mend. Turqia ka të drejtë të ketë politikën e vet të jashtme. Dhe e ka. "Unë ndërmerjet Azisë dhe Europës", siç e përcaktonte veten, e vëmendshme të mos ketë "asnjë armik në kufijtë e vet", ndërkohë që për një periudhë të gjatë vetëm ka akumuluar armiq përreth, ajo zhvilloi tashmë një politikë të diktuar gjerësisht nga opinioni i vet publik, nga fqinjësia dhe nga interesat tregtare, me qëllim të kapërcelje ngërçet që e kishin mbërthyer qysh pas Luftës së Dytë Botërore. Për t'u bërë sërish pjesë e koncertit europian, për të cilin ka qenë për shumë kohë "e sëmurë", ajo kishte nevojë atëherë të dilte nga izolimi, t'i bënte ballë komunizmit, të modernizonte ushtrinë, gjë që e arriti në sajë të Amerikës, të NATO-s, të Bashkimit Europian.

Për udhëheqësit turq kjo kohë është përmbyllur. Ata po i shumëzojnë marrëveshjet dhe vizitat me Sirinë, me Iranin, me Sudanin dhe po pleksen me organizatat islamiste ekstremiste. Tashmë vlen më shumë të jenë kreu i krenarisë muslimane sesa shembulli i islamit laik. Këtu shënohet ndërrimi i kampit. Kjo shpjegon përse "flotilja e Gazës" u inkurajua, u mbështet dhe u lëvdua nga qeveria turke, ndërkohë që ishte e organizuar nga një OJQ e lidhur me Hamasin, organizatë terroriste sipas Europës dhe, ndoshta, edhe më keq, nga vëllezërit muslimanë. Kjo flotilje e dëmtoi imazhin e Izraelit, dhe ky ishte qëllimi i saj. Kjo shpjegon gjithashtu përse Turqia votoi kundër Europës dhe Shteteve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, kur ai vendosi sanksione ndaj Iranit, përse mbështet Presidentin e Sudanit, i kërkuar nga Gjykata Penale



““

Për udhëheqësit turq kjo kohë është përmbyllur. Ata po i shumëzojnë marrëveshjet dhe vizitat me Sirinë, me Iranin, me Sudanin dhe po pleksen me organizatat islamiste ekstremiste. Tashmë vlen më shumë të jenë kreu i krenarisë muslimane sesa shembulli i islamit laik. Këtu shënohet ndërrimi i kampit. Kjo shpjegon përse "flotilja e Gazës" u inkurajua, u mbështet dhe u lëvdua nga qeveria turke, ndërkohë që ishte e organizuar nga një OJQ e lidhur me Hamasin, organizatë terroriste sipas Europës dhe, ndoshta, edhe më keq, nga vëllezërit muslimanë.

Ndërkombëtare, përse ushtarët turq nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në luftime në Afganistan, përse Organizata e Konferencës Islamike, sekretariatit e së cilës e mban Turqia, po ashtu si edhe Lidhja Arabe, ku ajo është vëzhgues, janë aq të rëndësishëm për diplomacinë e saj. Parë nga Turqia, kjo politikë edhe mund të shpjegohet, po ajo nuk ka asgjë të përbashkët me interesat e Europës, kundër të cilave po shkon gjithnjë e më shumë. Dihet se Bashkimi Europian përçahet pa hesap kur është fjala për anëtarësimin e Turqisë me të, anëtarësim ky i shtytur përgjithësisht nga anëtarët më të

rinj apo edhe nga vendet e vogla, domethënë ata që nuk e vrasin mendjen që BE të ketë një politikë fuqie. David Cameron e William Hague, Carl Bild e Martti Ahtisaari, José Luis Zapatero dhe të gjithë ata që kanë një ide të gabuar për politikën e jashtme europiane, të cilët pohojnë pa shaka se Turqia do ta shtonte peshën e Bashkimit, por që në fakt i druhen shantazhit apo bojkotit turk të ndërmarrë nga një diplomaci efektive, u kundërvihen përfaqësuesve të vendeve themeluese. Këta të fundit, përkundër ç'pohojnë, më së pari nuk nisen nga vlerësime të politikës së brendshme, ani pse tashmë një shumicë e europianëve nuk e dëshiron më këtë anëtarësim. Ata janë gardianët e Europës së zanafillës, asaj që ka vokacionin të bëhet gjithnjë e më politike, gjithnjë e më e bashkuar dhe me aspiratën për të peshuar shumë e më shumë në botë. Gjithkush e dit se Bashkimi ka nevojë për dendësi e jo për hollim. Udhëheqësit europianë në të kaluarën kanë dalë në fakt jashtë bindjes së tyre dhe kanë bërë gabimin strategjik madhor duke i propozuar anëtarësimin një partneri të pastabilluar, anëtarësimin në vend që t'i propozonin një partneritet strategjik, i cili do të ishte prova e vetme e interesave të përbashkëta për një vend në kërkim të identitetit. Kjo i jep sot rast Ankarasë t'u mbushë mendjen turqve se Europa nuk i do, ndërkohë që Europa dëshiron një dialog të vërtetë dhe aleanca të vërteta për çështjet globale, gjë që udhëheqësit turq nuk e kanë prioritet. Ata synojnë të rifitojnë statusin e një fuqie rajonale, me peshë në skenën ndërkombëtare, qoftë edhe pse nuk kanë dëshmuar ende se janë të gatshëm të paguajnë çmimin, domethënë sakrificat në emër të interesit të përgjithshëm dhe të kuptimit të përgjegjësive ndërkombëtare. Në fund të fundit, ndërprerja e gjenocidit në Darfur, i kundërshtuar nga Kryeministri turk, pengimi i talebanëve për t'u kthyer në pushtet apo shumangia e përhapjes së armëve bërthamore, janë kauza që meritonin lidhjen më të gjerë të mundshme. Në Uashington ashtu si në Berlin, në Paris, në Hagë, në Vjenë, në Budapest e në të gjitha kryeqytetet e përgjegjshme ka tashmë dyshime mbi evolucionin e Turqisë. Rezultatet e referendimit mbi Kushtetutën e re vetëm sa e kanë përforcuar shqetësimin. Për të shmangur krizat e vështira, për të qenë në gjalë të fundit në lartësinë e ambicieve të veta ndërkombëtare, Bashkimi Europian i mbetet të korrigojë sa më shpejt këtë gabim madhor, zgjatja e të cilit bëhet edhe më e kushtueshme, duke i detyruar kandidatët për anëtarësim të rreshtohen të politika e tij e jashtme.

PËRKYTHEU: BESNIK MUSTAFAJ